



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit
Periudha raportuese	<b>Qershor 2016</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Drita Rudi , Valbona Gashi

#### *1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues*

Gjatë muajit raportues janë realizuar shumë takime të planifikuara:

- Është përgatitur raporti mujor nga Sektori i kulturës dhe institucioneve varëse të DKRS-së;
- Planifikimi dhe organizimi i 1 Qershorit “ Prishtina lexon”;
- Planifikimi dhe organizimi i 11 Qershorit, për Ditën e Çlirimit të Prishtinës;
- Organizimi i takimeve të para në Kosovë “Takime korale”, me nxënës të shkollave fillore të Prishtinës;  
Planifikimi dhe organizimi i ekspozitës “ Prishtina e humbur”;
- Planifikimi dhe organizimi i 21 Qershorit “Festa e muzikës ”;
- Sa i përket çështjes gjinore, mbarëvajtja e përgjithshme e punës është realizuar me sukses, si takimet me palë, bashkëpunimi/konsultimet me organizata vendore dhe ndërkombëtare relevante , organizimi i takimeve, pjesëmarrjet, planifikimi për aktivitete etj.
- QKF :
  - 1 qershori – Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;
  - 14 qershor, konkursi për pikturë dhe fotografi;
  - 15 qershor, vizitë në Ambasadën e Finlandës;
  - 15 qershor, prezantimi i Ansambllit të Valleve në koncert në Sallën e Kuqe;
  - Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin Ndërkombëtar të Valleve, në Zagreb, Kroaci.
- **Arkivi i Qytetit** të Prishtinës ka vazhduar punën sipas planit të punës në rregullimin e materialit arkivor, fondi: Avokatura Publike, regjistrimin e librave amzë në mënyrë elektronike të shkollës së mesme “7 Shtatori”;
  - Janë përgjigjur në 75 kërkesa të palëve lidhur me dokumentacionin e kërkuar nga ana e tyre.
  - Janë realizuar dy takime me drejtorin e Pronës, z . Kukaj, dhe janë dhënë propozime për fillimin e digjitalizimit të materialit arkivor në Drejtorinë e Pronës.

- Biblioteka gjatë muajit qershor nuk ka pasur aktivitete, për shkak të bartjes në objektin e ri në lagjen “Dardania” dhe angazhimit të stafit në radhitjen e fondit librar, ku është ndërprerë puna me lexues, ndërsa në degët e bibliotekës janë realizuar aktivitetet e përhershme sipas planit mujor.
- Gjatë muajit qershori në teatrin “Dodona” janë zhvilluar një sërë aktivitete për realizimin e shfaqjeve të programit të rregullt, si dhe aktivitete përgatitore për realizimin e premierave të reja.

## Rini dhe Sport

- Gjatë muajit qershor është proceduar pjesa e fundit për gjashtëmujorin e parë të vitit 2016 e kërkesave të sportit, të miratuara nga komisioni, i cili ka bërë shqyrtimin e tyre në muajt prill dhe maj për subvencionim të projekteve sportive;
- Pas përfundimit të procedurave për përgatitjen e dokumenteve për ndërtimin e këndeve të lodrave, gjatë këtij muaji kanë filluar punimet e projekteve nga viti i kaluar për ndërtimin e këtyre këndeve të lodrave për fëmijë, në lagjet “Dardania” “Kodra e Diellit”, Kalabria” dhe “Kodra e Trimave”;
- Organi mbikëqyrës, i caktuar nga Kryetari, gjatë këtij muaji ka përcjellë zhvillimet e punimeve në terren, të cilat janë duke u kryer nga operatorët fitues, ku do të vazhdojë me mbikëqyrje deri në realizimin final të tyre, bazuar në planin dinamik të tyre;
- Janë zhvilluar aktivitete të ndryshme sportive, të cilat kanë pasur për qëllim shënimin e Ditës së Çlirimit të Prishtinës, si garat në peshkim. Vlen të ceket edhe turneu në volejball, i cili ka pasur karakter ndërkombëtar, pasi që pjesëmarrës ishin edhe ekipe nga rajoni, si ai nga Bursa e Turqisë, Mali i Zi etj. Këto projekte të cilat janë zhvilluar për nder të Ditës së Çlirimit të Prishtinës, janë përkrahur nga Komuna e Prishtinës, gjegjësisht nga Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit;
- Para ndeshjeve të këtij turneu të volejbollit, është bërë pritje zyrtare nga stafi i DKRS-së për ekipin e volejbollit “Bursas” nga Bursa e Turqisë, si dhe zyrtarët e Komunës së Bursës, të cilët ishin prezent gjatë gjithë turneut, ku të njëjtit shprehën gatishmëri për bashkëpunim të mëtutjeshëm me Komunën e Prishtinës.
- Jemi duke i shqyrtuar kërkesat e dy klubeve sportive për regjistrim, atë të gjimnastikës “Elita” dhe të parkourit “Parkour School Prishtina”, të cilat i kemi pranuar në muajin maj 2016. Ende nuk i kemi licencuar, sepse jemi duke i verifikuar dokumentet nëse plotësojnë kriteret mbi regjistrim të klubeve publike sportive.

## **2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues të parapara me plan programin e Komunës për drejtorinë tuaj.**

### **Kultura**

- 1,2 dhe 3 qershori;
- 1 qershor, Ceremonia e gradimit të maturantëve të shkollave të mesme "Sami Frashëri I", ku është bërë sigurimi i zërimit, LIED - it, karrigeve;
- 10 qershor, kërkesa polici, kërkesa në "Sport-Marketing";
- 11 Qershori, organizimi i takimeve të para në Kosovë " Takime korale", me nxënës të shkollave fillore të Prishtinës, Planifikimi dhe organizimi i ekspozitës " Prishtina e humbur";
- Planifikimi dhe organizimi i 21 qershorit "Festa e muzikës";
- 28 qershor, ceremonia e gradimit të maturantëve të shkollave të mesme " Eqrem Çabej", "Sami Frashëri II", "Dr. Ali Sokoli " dhe SHML "Prenk Jakova";
- QKF:
  - 1 qershor, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve;
  - 14 qershor, konkursi për pikturë dhe fotografi;
  - 15 qershor, vizitë në Ambasadën e Finlandës;
  - 15 qershor, prezantimi i Ansambllit të Valleve në Koncert në Sallën e Kuqe;
- Teatri "Dodona" ka planifikuar të realizohen 11 repriza të shfaqjeve nga repertori i Teatrit të Kukullave:
  - 6 repriza të tri shfaqjeve për të rritur;
  - Realizimi i një ekspozite të fotografisë së artistit Vigan Nuza, me titull "Classic";
  - Mbajtja e shfaqjeve të diplomimit të studentëve të Fakultetit të Arteve Dramatike, si formë bashkëpunimi mes Teatrit dhe këtij fakulteti;
  - Realizimi i 2 aktiviteteve kulturore, në bashkëpunim me institucionet parashkollore;
  - Arkivi nuk realizoi aktivitetin e paraparë, seminari 5 ditorë i organizuar nga Agjencia e Arkivave të Kosovës, për shkak buxhetit.

### **Rini dhe Sport**

- 12-14 qershor, turneu në volejboll për nder të Ditës së Prishtinës;
- Thirrja për aplikim për subvencionim të OJQ-ve rinore.

## **3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

DKRS-ja realizoi të gjitha aktivitetet e planifikuara për muajin qershor.

- 1,2 dhe 3 qershor "Prishtina lexon".

Në këtë aktivitet morën pjesë fëmijë të kopshteve publike dhe private, nxënës të shkollave fillore, aktorë profesionistë dhe muzikantë. Pjesëmarrës ishin edhe Biblioteka Kombëtare, Aleanca Franceze, Hendikos, SOS - Fshati, Karvani i shkrimtarëve dhe Fakulteti i Edukimit.

11 qershor, Dita e Çlirimit të Prishtinës

- Për nder të kësaj feste janë realizuar dy aktivitete, si :
  - Organizimi dhe realizimi "Takimet korale", pjesëmarrëse ishin koret e shkollave fillore të Prishtinës, ku morën pjesë mbi 250 nxënës me arsimtarë, udhëheqësit e koreve. Ky aktivitet u realizua për herë të parë nga paslufta në Kosovë. Arsimtarëve dhe shkollave pjesëmarrëse u janë dhënë mirënjohje për punën dhe kontributin e dhënë.
  - 11 qershor, realizimi i ekspozitës " Prishtina e harruar";
- Pjesëmarrje në hapje dhe vlerësim të tenderit për 1 Qershorin nga punëtorët e DKRS-së.
- Përgatitja e Deklaratës së disponueshmërisë për transportin me autobus për ansamblin " Bajram Curri ", për pjesëmarrje në Festivalin e këngëve dhe valleve në Belgjikë.
- 21 qershori, " Festa e muzikës";
- Bashkëkoordinim dhe përcjellje e aktivitetit të organizuar me rastin e 1 Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve "Prishtina lexon ", më 1, 2 dhe 3 qershor .
- Bashkëkoordinim dhe përcjellje e aktivitetit me rastin 21 Qershorit - Ditës së Muzikës .
- Pjesëmarrje në shpalljen e fituesve të konkursit me titull " Prishtina ime", në fotografi dhe pikturë, e organizuar nga Yunus Emre, Instituti "Qendra Kulturore Turke" në bashkëpunim me Qendrën Kulturore të Fëmijëve të Prishtinës, me rastin e 11 Qershorit - Ditës së Prishtinës;
- Teatri "Dodona" realizoi 11 repriza të shfaqjeve nga repertori i Teatrit të Kukullave.
  - 1 qershor "Libri shumëgjyresh",
  - 4 qershor "Kësulëkuqja" - 2 repriza,
  - 10 dhe 11 qershor "Cirku i lodrave" - 4 repriza,
  - 18 qershor "Fustani pika-pika" - 2 repriza,
  - 25 qershor "Libri shumëgjyresh" - 2 repriza.
- Janë realizuar 6 repriza të shfaqjeve për të rritur " Ikja nga Gjermania" (1 reprizë), "Ushtari i dy luftërave" (1 reprizë), "Cilën ta zgjedh" (2 repriza) dhe "Të jetosh në ishull" (2 repriza);
- Në muajin qershor është realizuar ekspozita e fotografive të artistit Vigan Nuza.

- Në kuadër të aktiviteteve dytësore, janë mbajtur provimet e Akademisë së Arteve të Bukura;
- Në kuadër të bashkëpunimit me institucione parashkollore, janë realizuar 2 programe, me IP "Dea" dhe IPPP "Fillesa";
- Më 12,13 dhe 14 qershor në Prishtinë, u mbajt turneu "Çlirimit i Prishtinës", ku vendin e parë e zuri "Bursaspor" nga Bursa, Turqi; vendin e dytë e zuri "Drita" nga Gjilani; vendin e tretë e zuri "Rudari" nga Plevla, Mali i Zi, si dhe vendin e katërt e zuri Prishtina.

#### Rini dhe Sport

- Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në planprogramin e punës së vet për vitin 2016, ka paraparë të financojë projekte sportive dhe rinore, duke u bazuar në "Thirrje për aplikim". Pasi që "Thirrja për aplikim" për projekte sportive është përfunduar në muajt paraprak, gjatë këtij muaji, pra në qershor 2016, është shpallur edhe "Thirrja për aplikim" për financimin e projekteve rinore, ku Komuna e Prishtinës, përkatësisht DKRS, ka ftuar të gjitha OJQ-të rinore të cilat implementojnë projekte rinore, që të aplikojnë për financim. Projektet duhet të jenë në përputhje me Planin e veprimit rinor lokal 2016-2018. "Thirrja për Aplikim" ka qenë e publikuar në web-faqen e Komunës së Prishtinës dhe faqen zyrtare në "facebook" dhe projektpropozimet janë pranuar nga data 09.06.2016 deri më 21.06.2016.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

##### Kulturë

- Organizimi, sigurimi i transportit dhe realizimi i pjesëmarrjes së SHKA " Bajram Curri;
- QKF-ja është në përgatitje për festivalin ndërkombëtar të valleve në Kroaci;
- Përgatitja e deklaratës së disonushmërisë për transportin dhe ushqimin e QKF-së gjatë udhëtimit ( vajtje - ardhje);
- Teatri "Dodona" ka filluar provat për realizimin e shfaqjes mysafire "Buna dhe Tuli", të shoqatës kulturore "Molla e Kuqe";
- Pas grumbullimit të projektpropozimeve të OJQ-ve rinore, të cilat janë pranuar në zyrat pritëse, për periudhën 09.06.2016 deri më 21.06.2016, zyrtarët e Sektorit për rini janë duke i seleksionuar projektet, të cilat në bazë të vërejtjes që është publikuar në

“Thirrje”, është cekur që projektet të cilat nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet sipas kërkesës dhe aplikuesit të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga edicionet e kaluara ndaj DKRS -së, nuk do të merren parasysh nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave;

- Gjatë muajit korrik të këtij viti, pritet të mbahet takimi me komisionin e caktuar për shqyrtimin e kërkesave në fushën e rinisë.

#### **4.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese**

##### **Kultura**

- Në muajin maj është bërë pagesa e 18 projekteve, të subvencionuara nga komisioni vlerësues, në shumë prej 48, 450 €.

##### **Sporti**

- Në muajin maj është bërë pagesa e projekteve të 52 klubeve dhe shoqatave sportive, me vlerë të përgjithshme prej 57,658 €, të aprovuara nga komisioni për shqyrtimin e kërkesave të sportit, të shqyrtuara në muajin prill dhe maj 2016.

#### **4.1.3 Takimet me palë**

- Takime të vazhdueshme rreth informacioneve për subvencione, raporte, si dhe konsultime për kulturë dhe çështje gjinore, si dhe informacione bazuar në nevoja të drejtorisë.
- Takim me OJQ-në “Jeta - Vita”, lidhur me mundësinë e shfaqjes e filmit “Tri dritare, një varje”. Ky film planifikohet të shfaqet në shkolla, shesh, teatrin “Dodona” etj.;
- Takime me disa prindër të interesuar për t’i regjistruar fëmijët ne QKF.

##### **Sport dhe Rini**

- Takime me përfaqësues të klubeve sportive të kryeqytetit, për të diskutuar rreth nevojave dhe kërkesave të ndryshme në fushën e sportit, përfshirë këtu

- edhe kërkesat nga klubet sportive rreth mbështetjes ose mosmbështetjes financiare të projekteve të tyre;
- Takime me përfaqësues të OJQ-ve rinore, të cilët u njoftuan për “Thirrjen për aplikim”, që do të bëhet në muajin qershor, për subvencionim të OJQ-ve të ndryshme rinore.

## 5. Takimet me institucione të tjera

### **Kultura**

- DKRS ja ka bashkëpunuar me Drejtorinë e Arsimit. Mbi këtë bazë është bërë organizimi i Gradimit të maturantëve të shkollave të mesme: “Eqrem Çabej”, “Sami Frashëri II”, “Dr. Ali Sokoli” dhe SHML “Prek Jakova”;
- Takim konsultativ me “Save the Children” nga Lindita Hajdari dhe znj. Bogujevci, lidhur me vazhdimin e marrëveshjes së mirëkuptimit mes Komunës së Prishtinës dhe organizatës “Save the Children”. Pas takimeve të mbajtura, propozimin e marrëveshjes, si draft të parë, znj. Bogujevci e përcjelli në Zyrën ligjore komunale për procedim të mëtejshëm;
- QKF-ja realizoi takime me zyrtarë të Drejtorisë së Arsimit dhe Drejtorisë së Kulturës.

## 6. Diskutime publike / takimet me qytetarë

### 6.1.1 Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Nuk ka pasur kërkesa të tilla.

### 6.1.2. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër.

DKRS-ja në muajin qershor pranoi 131 kërkesa për mbështetje, subvencione.

Pranimi i raporteve të lëndëve të subvencionuara të fazave paraprahe.

Me udhëzim të drejtores, përgatitja dhe skanimi i lëndëve të kërkuara nga auditori.

## 7. Takime të tjera

- Takim me përfaqësuesit e SHKA “Bajram Curri”, rreth pjesëmarrjes në Festival;
- Takime të rregullta pune në kuadër të aktiviteteve të shumta të Teatrit.

## 8. SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.

### Rini dhe Sport

- Vlen të përmenden disa vështirësi gjatë fillimit të punimeve në ndërtimin e këndeve të lodrave për fëmijë në lagjen “Dardania”, ku punëkryesi ka hasur në pengesë nga banorët e lagjes. E gjitha kjo ka ardhur si pasojë e bllokimit të njëres pjesë të parkingut, e cila patjetër është dashur të bllokohet nga punëkryesi, sepse lokacioni i parapare për ndërtim është paralel me parkingun.

## 9. REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve nëse keni dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë, etj.

- DKRS – ja ka nevojë që të plotësohet stafi me një ekonomist dhe një punëtor administrativo–teknik.
- Arkivi rekomandon që gjatë muajit pasues të filloni riparimet e kulmit të ndërtesës së Arkivit, sipas shkresës së dërguar.

## 10. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

### Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- QKF-ja planifikon të dërgojë ftesat zyrtare për Festivalin ndërkombëtar të valleve “Ylberi i Prishtinës” 2016. Meqenëse festivali është ndërkombëtar, ftesat duhet t’u dërgohen shteteve të ndryshme të rajonit;
- Përgatitjet për pjesëmarrje në Festivalin ndërkombëtar të valleve në Kroaci;



- Realizimi i udhëtimit të QKF në Festivalin ndërkombëtar të valleve në Kroaci;
- Përgatitjet e Ambasadorëve të rinj për debate;
- Përgatitjet për realizimin e udhëtimit të SHKA “Bajram Curri” në Namur, Belgjikë.

### **Rini dhe Sport**

- “Thirrja për aplikim” për subvencionim të OJQ-ve rinore.

### **11. TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme**